MARMOFIX
NATURA

Të dhënat teknike

Përshkrimi i produktit

MARMOFIX Dispersionsfarbe Innen: Ngjyrë disperzive me kualitet shumë të mirë për përdorim në sipërfaqe të brendshme.

- Fuqi të shkëlqyeshme mbuluese
- Bardhësi të lartë
- Stabilitet të gjatë të ngjyrës
- Pamje të rrafshtë mat
- Veti tejet të mira për punë dhe veti rrjedhjeje pa spërkatje gjatë aplikimit
- Ngjitje të fortë dhe tharje të shpejtë
- Zgjidhje ekonomike për ngjyrosje të shpeshtë dhe për rifreskim të sipërfaqeve
- Pa amonjak

DISPERSIONSFARBE ECONOMIC
Innen

Përdorime të rekomanduara

Është dedikuar për përdorim mbrojtës dhe dekorativ në sipërfaqe të brendshme të mureve me llaçe, beton, tulla, dru, stuko, pllaka gipsi, plastikë (dhoma ndeje, zyra etj).

...GARANTIERTE
QUALITÄT!

www.marmofix.ch

Marmofix DOOEL Chelopek, Brvenica
Address: 101 Str, No. 3, Chelopek, 1216
Tetovo, R. North Macedonia
Tel: +389 75 211 222

MARMOFIX
NATURA

Të dhënat teknike
DISPERSIONFARBE Innen

Karakteristika teknike

Rrëshira	Kopolimer akrilik
Dendësia(bardhë)	1,60±0,05 gr/ml
Viskoziteti pas prodhimit (bardhë) **Viskoziteti gjatë ruajtjes (bardhë)**	105±5 KU 23°C 105±5 KU 23°C
Harxhimi	Varësisht nga absorbimi, porozitetí, dhe tekstura e sipërfaqes, harxhimi mesatar për dy shtresa është: 0.20–0.25 kg/m^2
Tharja (bardhë) **Koha për riaplikim (bardhë)** **Tharja (nuancat)** **Koha për riaplikim (nuancat)**	35±10 minuta 1±¼ ora 40±10 minuta 2±¼ orë (Koha e tharjes dhe riaplikimit mund të zgjasë me tepër në temperatura të ulëta dhe lagështi të lartë relative)
Nuancat	E disponueshme në ngjyrë të bardhë dhe qindra nuanca tjera bazuar në SISTEMIN E NGJYROSJES MARMOFIX (MARMOFIXTINTING SYSTEM (MTS)
VOC (Komponime të avullueshme organike)	Vlera kufitare e këtij produkti të kësaj kategorie A/a është 30g/l (2010). Produkti përmban maksimum 29g/l.

Përgaditja e substratit dhe instruksione për aplikim

- Përgaditja e substratit
  Substrati duhet të jetë i pastër, i thatë dhe të mos përmbajë material defektiv dhe të ngjitur dobët për sipërfaqen si për shembull pluhur, yndyrë, kripë, etj. Sipërfaqet e reja dhe vjetra duhet të impregnohen me TIEFGRUND TG-130 PRIMER, të holluar deri 50% me ujë.
  Sipërfaqet me myshk dhe alga duhet të pastrohen/dezinfektohen para aplikimit të astarit.

- Përgaditja dhe aplikimi
  Metoda e aplikimit: Furçë, rul, spërkatje pa ajër
  Hollues: Ujë
  Hollimi: 10-20% v/v
  MARMOFIX Dispersionsfarbe Innen zakonisht aplikohet në dy shtresa.
  Në sipërfaqe të vazhdueshme të murit duhet të aplikohet pa ndërprerje, për tu shmangur sipërfaqeve të ngjyrosura në mënyrë të pabarabartë, tharje jo të njëtrajtshme etj.
  Aplikimi nuk duhet të bëhet në temperatura më të ulëta se +5°C dhe mbi +30°C. Gjatë dhe pas të gjitha aplikimeve, produktet duhet të mbrohen nga ndikimet atmosferike. Mjetet duhet të pastrohen me ujë menjëher pas përdorimit.

Përdorimi dhe ruajtja

Duhet të mbahet larg fëmijëve. Nuk nevojiten masa të veçanta gjatë punës me MARMOFIX Dispersionsfarbe Innen. Kur produkti aplikohet me spërkatje, përdorni doreza mbrojtëse, syze mbrojtëse, dhe maskë. Në rast kontakti me sytë ose lëkurën, lani me sasi të bollshme të ujit, dhe sipas nevojës kërkoni ndihmë mjekësore.
Mbetjet e produktit duhet të hudhen sipas rregullave lokale. Nuk duhet të hudhet në kanalizime apo mjedis. Mbetja e thatë ose e ngurtësuar mund të hudhet si mbetje nga vendi i punëve ndërtimore ose si mbeturinë shtëpiake.
MARMOFIX Dispersionsfarbe Innen duhet të ruhet në temperatura mes +5 °C dhe +25 °C si dhe larg dritës së diellit. Në kovat origjinale të pahapura nën kushtet e lartëpërmendura, MARMOFIX DispersionsfarbeHD Innen mund të ruhet për 24 muaj.

Paketimi

Kova 20 kg